



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË ,USHQIMIT DHE MBROJTJES
SË
KONSUMATORIT
DPSUMK

Adresa: "Sheshi Skënderbej", Nr. 2, Tiranë

Tel/Fax +355 04 225 539

Nr. 1870 Prot.

Tiranë, më 19.04 2006

URDHËR
Nr. 203 dt. 19.04.06

PËR

**PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË SUBJEKTEVE PËR
IMPORTIN, EKSPORTIN DHE TRANZITIMIN E KAFSHËVE TË
GJALLA DHE PRODUKTEVE ME ORIGJINË SHTAZORE**

Mbështetur në nenin 102 pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të ligjit Nr. 9308, dt.04.11.2004 " Për Shërbimin dhe Inspektoriatin Veterinar"


URDHËROJ:

1. Miratimi dhe regjistrimi i subjekteve të reja që importojnë, eksportojnë dhe tranzitojnë kafshë të gjalla, produkte dhe nënprodukte me origjinë shtazore dhe rinovimi i subjekteve eksistuese bëhet brënda datës 25 Janar të cdo viti.
2. Inspektoriati Veterinar i Shëndetit të Kafshëve dhe i Sigurisë Ushqimore në DRBUMK, pas inspektimit dërgon listën e subjekteve të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithëshme të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit brënda datës 31 Janar të cdo viti .
3. Deri në hyrjen në fuqi të listës së re DRBUMK dhe PIK operon me listën ekzistuese.

Drejtoria e Përgjithëshme e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

4. Regjistrimi i subjekteve të reja që do të ushtrojnë aktivitet importues, eksportues dhe tranzitues të kafshëve të gjalla dhe të produkteve me origjinë shtazore bëhet gjatë gjithë vitit. Këto subjekte i shtohen listës dhe Inspektoriati Veterinar i Shëndetit të Kafshëve dhe Sigurisë Ushqimore në DRBUMK e dërgon atë në MBUMK brënda 5 ditëve.
5. Subjektet e regjistruara, të inspektura nga inspektoritai veterinar i DRBUMK dhe i Drejtorisë së Përgjithëshme të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në MBUMK që pas inspektimit rezultojnë se nuk plotësojnë kushtet sanitaro-veterinare pezullohen nga aktiviteti hiqen nga lista e miratuar deri në plotësimin e kushteve saniatro veterinarë. Keto ndryshime dëgohen në Drejtorinë e Përgjithëshme të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në MBUMK brënda 5 ditëve.
6. Listat miratohen në Drejtorinë e Përgjithëshme të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit e cila e dërgon në DRBUMK brënda 10 ditëve. DRBUMK e dërgon në PIK brënda ditës.
7. Inspektoriati Veterinar i Shëndetit të Kafshëve dhe i Sigurisë Ushqimore të qarkut plotëson dhe ruan dosjen me të gjithë dokumentacionin për cdo subjekt që ushtron aktivitetin e import,eksportit dhe tranzitimit të kafshëve të gjalla, produkteve dhe nënprodukteve me origjinë shtazore.
8. Cdo subjekt në frigoriferet dhe magazinat e tyre vendos ne hyrje listën e produkteve të magazinuara dhe origjinën e tyre dhe për cdo produkt mban Cerifikatën Veterinare të shtetit importues të noterizuar. Subjekti depoziton të gjithë protokollet e inspektimeve veterinarë të cilat është i detyruar ti paraqesë kur i kërkohen gjatë inspektimit.
9. Kafshet e gjalla lejohen te futen dhe te dalin nga territori i Republikës se Shqiperise, vetem ne keto Pika te Inspektimit Veterinar Kufitar:
 - a) Aeroporti i Rinasit
 - b) Porti detar i Durrësit
 - c) Hani i Hotit, Malesi e Madhe
 - d) Morine, Kukes
 - e) Qafe Thane, Pogradec
 - f) Kakavi, Gjirokaster
10. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen Drejtoria e Përgjithëshme e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoritë Rajonale Bujqesisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit.
11. Urdhërat e mëparshëm për zbatimin e këtyre procedurave shfuqizohen.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTER


Jemin GJANA